

AKT THEMELIMI DHE STATUT I SHOQERISE

ORNEL SHPK

KAPITULLI I

KRIJIMI, FORMA, QELLIMI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, EMERTIMI, SELIA

NENI 1

KRIJIMI I SHOQERISE

1. Sot ne date 25.07.2020 themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emertimin "ORNEL" shpk, (Me poshte referuar si "Shoqeria").
2. Shoqeria eshte person juridik shqiptar dhe funksionon ne perputhje me kerkesat e ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" te ndryshuar.
3. Shoqeria gezon te drejta si person juridik shqiptar qe prej dates, ne te cilen organet kompetente kane dhene aprovimin per themelimin e saj.
4. Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne dokumentat themeluese.

NENI 2

FORMA E SHOQERISE

1. Shoqeria do te kete formen e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, per sa kohe qe Ortaket e kesaj shoqerie nuk do te marrin nje vendim per shnderrimin e saj.
2. Veprimatria e shoqerise do te rregullohet sipas radhes nga dispozitat e ketij statuti dhe dispozitat perkatese te ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", te ndryshuara, per aq kohe sa dispozitat e ketij statute nuk vijne ne kundershtrim me ligjin e mesiperm.

NENI 3


EMERTIMI

Emertimi I shoqerise eshte "ORNEL" sh.p.k. Ne te gjitha aktet dhe dokumentet e nxjerra nga shoqeria, emertimi I shoqerise do te ndiqet nga fjalet "Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar" ose inicilalet sh.p.k.

NENI 4

SELIA E SHOQERISE

1. Shoqeria e ka seline ne qytetin e Fierit, ne adresen Fier, Fier, Lagjja Sheq I Madh, Rruga Teodor Muzaka II, Godina nr. 2/39.



2. Përveç veprimatrise në nivel lokal, shoqëria ka të drejtën e krijimit dhe mbylljes së filialeve, agjencive dhe xyrave të përfaqësimit brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.
3. Selia mund të transferohet në çdo vend tjetër brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me një vendim të Asamblesë së Ortakëve të kësaj shoqërie.

NENI 5 **KOHEZGJATJA**

1. Kohezgjatja e shoqërisë është pa afat
2. Në përputhje me këtë statut, shoqëria mund të mbyll veprimatrise të saj në çdo kohë e kur e shihet të arsyeshme, apo në rastet e parashikuara nga ligji.

NENI 6 **QELLIMI DHE OBJEKTI**

1. Objekti i veprimatrise së shoqërisë është:
“Fason Tekstile.Prodhim tekstile, logjistike, përpunim i lëndës së parë, shitblerje konfeksionetextile, rrobaqepsi, për lëndë të parë dhe të përpunuar, import eksport i tyre për llogari të vetdhe të tjetër”
2. Shoqëria mund të ndryshojë dhe të shtojë në çdo kohë objektin e veprimatrise së saj sipas rregullave të parashikuara në statutin e saj dhe në legjislacionin tregtar.

KAPITULLI II **KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE**

NENI 7 **KAPITALI THEMELTAR**

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është në vlerën 100.000 (njëqind mijë) Leke. Ai mund të rritet me vendim të asamblesë sipas normave të fushës në fuqi.

NENI 8 **ORTAKET DHE KUOTAT**



Shoqeria perbehet nga 1 ortak i vetem. Ortake i shoqerise eshte:

1. Ornel Ajdinaj, shtetase shqiptare, madhore me zotesi juridike per te vepruar, i biri i Petrit lindur ne date 01.10.1976 ne Berat, banuese ne Berat, me Karte ID Nr.H61001053K qe zoteron 100% te kuotave ose 100.000,00 Leke.

Kuotat e pjesemarrjes jane ne zoterim te Ortakeve ndahen si me poshte:

Ornel Ajdinaj – 100% ne vlere 100.000,00 leke

NENI 9

MENYRA E FITIMIT DHE KALIMIT TE KUOTAVE

1. Kuotat e kapitalit te shoqerise e te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:
 - a. Kontributit te ortakëve ne kapitalin e shoqerise:
 - b. Shitblerjes
 - c. Trashegimise
 - d. Dhurimit
 - e. Cdo menyre tjeter parashikuar ne ligj.
2. Ne rastet e kalimit te kuotave me kontrate, kushtet dhe momenti i kalimit te titullit te pronesise mbi kuoten, si dhe kushtet e tjera te kalimit, perfshire momentin e pageses se cmimit, rregullohen nga kontrata.
3. Kontrata per kalimin e kuotes hartohet ne forme shkresore dhe noterizimi nuk perben kusht per vlefshmerine apo regjistrimin e kontrates.
4. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palet bien dakord ne kontrate, vlefshmeria e kalimit te titullit te pronesise mbi kuotat nuk do te kushtezohet nga kryerja e formaliteve te ndryshme me efekt deklarativ perfshi ketu formalitetet e regjistrimit ose te publikimit te kontrates apo te kalimit te titullit.
5. Me perjashtim te kalimit te kuotave nepermjet trashegimise, ne rastet e tjera ortakët duhet te miratojne me vendim te asamblese, transferimin e kuotave jashte shoqerise. Pas momentit te kalimit te kuotave me ane te trashegimise, per trashegimtaret zbatohen dispozitat e parashikuara ne piken 3-10 te ketij neni.
6. Ortaket ne rastin kur mendojne qe te transferojne pjeserisht apo teresisht kuotat e tyre nepermjet shitblerjes duhet te kryejne procedure e parablerjes se kuotave ndaj te ortakëve te tjere. Afati qe secili nga ortakët duhet te vlersoje oferten eshte 90 (nentedhjete) dite kalendarike nga data e marrjes se ofertes.
7. Oferta duhet te dergohet ne forme te shkruar (poste rekomande) dhe ne forme elektronike (email), ne adresen e secilit ortak te regjistruar prane shoqerise. Ortaku detyrohet te

depozitaje ndryshimet e adreses se banimit prane shoqerise. Ne rastin qe ortakët nuk e kane depozituar ndryshimin prane shoqerise, ortakët qe kerkon te shese ose transferoje mund te njoftoj direkt ne adresen e shoqerise, ndaj prezumohet qe ortakët e tjere, kane marre dijeni brenda 7 diteve nga dita e mbritjes se njoftimit ne adresen zyrtare te shoqerise.

8. Oferta duhet te permbaje daten, adresen e sakte te ortakut qe I drejtohet, numrin e kuotave qe kerkon te disponoj, cmimin e ofruar per kuote dhe/ose ne total, formen e monedhes (nese eshte ndryshe nga ajo e kapitalit te regjistruar te shoqerise) dhe kursin e kembimit, kushtet e shitjes, afatin e kthimit te pergjigjes, adresen e sakte (vendin ku ortakët/et do qe te vijne pergjigjet e ofertave dhe emailin) te ortakut qe kerkon te shese kuotat. Mosrespektimi I ketyre elementeve e ben oferten te pavlefshme. Nese ortakët nuk vendos adrese ne oferte, atehere adresa eshte vendbanimi I tij zyrtar I regjistruar ne gjendjen civile, te percaktuar ne kete statut. Nese njoftimi I eshte derguar ne kete adrese, konsiderohet qe ai eshte njoftuar.
9. Nese ortakët apo ortakët e shoqerise e pranojne oferten ne kushtet e parablerjes, ata duhet te shprehen qarte dhe hapur per vullnetin e tyre te lire dhe te pakushtezuar ne pranimin e ofertes.
10. Ne rast se ortakët brenda 60 diteve kalendarike refuzon oferten ose nuk shprehet fare ne lidhje me te, atehere procedura e parablerjes konsiderohet e kryer dhe ortakët eshte I lire qe te shese kuotat e tij jashte shoqerise me nje vlere te barabarte ose me te madhe se ajo e paraqitur ne oferte.
11. Ne cdo rast, asambleja duhet te miratoje shitjen e kuotave jashte shoqerise me shumice te cilesuar me anetaret qe jane prezente ne mbledhje, ne kete rast, vota e ortakut qe kerkon te shese kuotat, perjashtohet nga votimi.
12. Ndalohet shitja dhe/ose dhurimi I kuotave ndaj personave fizike apo juridike, veprimtaria e te cileve eshte ne konkurrence me shoqerine dhe duket hapur qe dhurimi apo shitja e tyre demton veprimtarine e shoqerise. Perjashtohet rasti, kur te gjithë ortakët e shoqerise, edhe pse sa me siper duket hapur, ata jane shprehur me vendim qe jane dakort me shitjen apo dhurimin e kuotave. Ne kete vendim, nuk perfshihet ortakët qe kerkon te shese apo dhuroje kuotat e tij.
13. Nese ortakët e tjere nuk ushtrojne te drejten e parablerjes, vec e vec dhe/ose sebashku, sipas afateve te percaktuara me lart, ortakët shites eshte I lire qe kuotat e ofruara tia shese te tretteve, brenda 30 (tridhjetë) diteve kalendarike, nga mbarimi I afatit prej 60 ditesh kalendarike ose nga dita e kthimit te pergjigjes negative nga ortakët e tjere.
14. Ne rast se te gjithë ortakët pranojne oferten e ortakut, atehere vlere e kuotave qe jane nxjerre ne shitje, ndahet ne perpjestim te drejte, me perqindjen e ortakeve te tjere ose te barabarte nese kuotat jane te shperndara ne menyre te barabarte.
15. Ne rast se ortakët qe kerkon te shese kuotat e tij pjeserisht apo plotesisht deshton ne shitjen e tyre dy here radhazi, keto kuota mund te anulohen ose likujdohen, me miratimin e ortakut, sipas nenit 80 te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite



tegtare”. Ne cdo rast, anulimi dhe likujdimi I kuotave ne fjale shoqerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme, vendimi per anulimin ose likujdimin duhet te merret me shumice te cilesuar te anetareve prezente ne mbledhjen e asamblese.

16. Kuotat qe shiten kane vleren fillestare te rregjistrimit te kapitalit fillestar, nese shoqeria deri ne momentin e fillimit te procedures se shitjes nuk ka bere ritje kapitali sipas ligjit dhe te rregjistruar ne QKB.

NENI 10

PASOJAT E KALIMIT TE KUOTAVE, PJESTIMI DHE TRANSFERIMI I TYRE

1. Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e perfiton ate, pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimetqe rrjedhin nga zoterimi I kuotes, nga casti I kalimit te kuotave, deri ne castin e rregjistrimit te kalimit, sipas pikes 2 te nenit 74 te Ligjit per Shoqerite tregtare.
2. Shoqeria realizon kalimin e kuotes, sipas nenit 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”.
3. Kuotat jane lirisht te transferueshme midis ortakeve te shoqerise. Rregulli I kushtezimit te transferimit nuk zbatohet ne rast te transferimit per shkak trashegimie ose transferimi tek pjestaret e familjes.

KAPITULLI III

KUFIZIMET E SHPERNDARJES, CERTIFIKATA E AFTESISE PAGUESE, PERGJEGJESITE

1. Shoqeria mund tu shperndaje fitim ortakeve, vetem nese pas pagimit te dividendit:
 - a. Aktive e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj;
 - b. Shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12-muajve ne vazhdim.
2. Administratori leshon nje certifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesat e paragrafit te pare te ketij neni, ndersa kur gjenjda e shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk I permbush keto kriteret, administrator nuk mund te leshoje kete certifikate.
3. Administratori pergjigjet ndaj shoqerise per vertetesine e certifikates se aftesise paguese.
4. Administratori, I cili nga pakujdesia leshon nje certifikate te pasakte te aftesise paguese, pergjigjet personalisht perpara shoqerise per kthimin e dividendeve te shperndare.
5. Ortaket, qe kane marre nga shoqeria dividend, pergjigjen personalisht ndaj shoqerise per kthimin e dividendeve, pavarsisht leshimit te certifikates, nese keta ortake kane pasur dijeni per gjendjen e paaftesise paguese te shoqerise sipas paragrafit te pare te ketij neni.



KAPITULLI IV
ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Organet drejtuese te shoqerise jane:

- 1. Asambleja e Pergjithshme**
- 2. Administratori**

ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

NENI 13
TE DREJTAT DHE DETYRAT

1. Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshjtjet e meposhteme:
 - a) Percaktimin e politikave tregtare te Shoqerise;
 - b) Ndryshimet e statutit;
 - c) Emerimin dhe shkarkimin e Administratorit
 - d) Emerimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
 - e) Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c dhe d, te kesaj pike;
 - f) Mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administrator, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - h) Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
 - i) Pjestimin e kuotave dhe anulimin etyre;
 - j) Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorit;
 - k) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
 - l) Per miratimin e marrjes se audituesve te jashtem, ne rastet e hetimeve te posacme;
 - m) Miratimin e strukture se shoqerise dhe nivelet e pagave per vend pune;
 - n) Shperndarjen e fitimeve per ortaket;
 - o) Investime afatshkurtra dhe afatgjata;
 - p) Miratimin e kontratave qe kalojne vleren 30.000 (tridhjetë mijë) Euro ose ekuivalentin ne Leke ose USD, ne muaj ose totale.
 - q) Miratimin e marrjes se kredive bankare;
 - r) Krijimin dhe perdorimine fondit rezerve te shoqerise ;
 - s) Shnderrimin e formes se shoqerise dhe/ose bashkimin me shoqeri te tjera, apo pjesemarrjen ne shoqeri apo grupe shoqerish;
 - t) Miratimin e formes, permbajtjes dhe perdorimit se regjistrit te shoqerise per regjistrimin e vendimeve te shoqerise, dhe strukturen pergjegjese per administrimin e tij;




- u) Miratimin e rregulloreve te ndryshme te punes si dhe rregulloreve te tjera qe ne thelb kane te bejne me procese te rendesishme te veprimtrise se shoqerise;
 - v) Miratimin ne rastin e shitblerjes se kuotave te ortakeve ose formave te tjera te transferimit te tyre, sipas parashikimeve te ketij statute.
 - w) Miratimin ne rastet e dhenies apo marrjes me qira te sendeve prodhuese te luajtshme.
2. Duhet regjistruar ne vecanti ne Qendren Kombetare te Biznesit, por p u kufizuar ne to, vendimet e asamblese per:
- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtrise;
 - b) Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) Investime;
 - d) Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
 - e) Vendime te tjera qe asambleja e pergjithshme vlerson se duhen regjistruar.
3. Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund ti kundrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se I treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te kishte pasur dijeni per te.

NENI 14

MBLEDHJA E ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

1. Asambleja e Pergjithshme mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligji Per Shoqerite tregtare, nga ligje te tjera ose dispozitat e statutit dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thirret te pakten 1 here ne vit.
2. Asambleja e pergjithshme thirret nga administratori dhe/apo ortakët e percaktuar sipas nenit 84 te ligjit "Per Shoqerite tregtare", Nr.9901, dt. 14.04.2008 te ndryshuar.
3. Asambleja e pergjithshme duhet te thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk I mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
4. Asambleja e pergjithshme duhet te thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 per qind te asetëve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
5. Asambleja e pergjithshme duhet te thirret kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas rregjistrimit te saj, propozon te blej nga nje ortak, pasuri qe kane vlere me te larte se 5per qind te asetëve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
6. Ne rastet e parashikuara ne pikat 3 e 5 te ketij neni, asamblese se pergjithshme I paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel I autorizuar, I pavarur.




7. Dispozitat e pikes 6 te ketij neni nuk zbatohen nese blerjet sipas pikave 4 e 5 te ketij neni, kryhen ne burse ose jane pjese e veprimeve te perditshme te shoqerise dhe behen ne kushte normale tregu.
8. Ne rastet e parashikuara ne pikat 3 deri ne 5 te ketij neni, asambleja e pergjithshme mund te miratoje nje resolute keshilluese, duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratorit.

NENI 15
MENYRA E THIRRJES

1. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese poste rekomande dhe me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e tu dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
2. Materialet e mbledhjes te percaktuara ne rendin e dites duhet te dergohen jo me vone se 3 (tre) dite nga dita e caktuar per zhvillim e mbledhjes, ne forme elektronike dhe me shkrese. Mosdergimi I tyre ne kohe konsiderohet si shkelje e procedures per thirrjen e asamblese dhe mbledhja konsiderohet e pavlefshme, me perjashtim te rastit kur te gjithe ortaket jane te pranishem ne mbledhje dhe jane dakort me moszbatimin e kesaj dispozite.
3. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavarsisht parregullsise.

NENI 16
KERKESAT NGA ORTAKET E PAKICES

1. Ortaket, te cilet perfaqesojne te pakten 5 per qind te totalit te votive ne asamblene e pergjithshme te shoqerise, apo nje pjese me te vogel te parashikuar ne statut, mund ti drejtojne administratorit nje kerkese me shkrim, perfshire posten elektronike, per te thirrur asamblene e pergjithshme dhe/ose perfshirjen e ceshtjeve te posacme ne rendin e dites. Kerkesa duhet te permbaje arsyet, objektivat dhe ceshtjet, per te cilat asambleja duhet te marre nje vendim. Nese kerkesa refuzohet, keta ortake kane te drejte ta therrasin asamblene dhe te caktojne ceshtjet e rendit te dite, ne perputhje me piken 1 te nenit 83 te ligjit Nr.9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare".
2. Nese, ne kundersizim me piken 1 te ketij neni, asambleja e pergjithshme nuk thirret, ose ceshtja e kerkuar prej ketyre nuk futet ne rendin e dites, secili prej ortakeve, qe kane bere kerkesen, k ate drejte:



- a) te ngreje padi ne gjykate, per te deklaruar shkeljen e detyrimit te besnikerise, nese administrator nuk permbush kerkesat e ortakeve brenda 15 diteve;
 - b) ti kerkoje shoqerise blerjen e kuotave, te zoteruara prej tyre.
3. Ne rastet kur rendi I dites ndryshohet, sipas parashikimeve te pikave 1 e 2 te ketij neni thirrja I eshte njoftuar ortakeve, administratori njofton perseri rendin e dites, te ndryshuar, ne perputhje me parashikimet ligjore dhe statuoere.
 4. Ndryshimet ne rendin e dites si rregull lejohen te behen jo me vone se 3 (tre) dite nga data e marrjes se njoftimit te zhvillimit te mbledhjes . Ne cdo rast, para fillimit te mbledhjes lejohet qe ortaket e pranishem, ne unanimitet mund te bejne ndryshime ne rendin e dites.
 5. Perfaqesuesi I autorizuar eshte I detyruar te deklarroje cdo fakt apo rrethane, te till qe, sipas gjykimit te ortakut te perfaqesuar, rrezikon te ndikojne ne vendimarrjen e perfaqesuesit per interesa te tjere te ndryshem nga at ate ortakut te perfaqesuar.

NENI 17


PERFAQESIMI NE ASAMBLE

1. Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi (ne rastet kur ortaku eshte person juridik) ose procure te posacme (ne rastet kur ortaku eshte person fizik) nga nje ortak tjetere apo nga nje peron I trete. Ne cdo rast perfaqesimi ten je apo disa ortakeve, drejtuesi I mbledhjes se asamblese duhet te verifikoj lighshmerine e uatorizimit te perfaqesimit. Perfaqesuesit e autorizuar do te pranohen ne mbledhje veten nese autorizimi I tyre ploteson kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar mbi perfaqesimin.
2. Administratori I shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues I ortakeve ne asamblene e pergjithshme.
3. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme , e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 18

KUORUMI PER VENDIMET ME SHUMICE TE THJESHTE

1. Ne rastin e marrjes se vendimeve qe kerkojne shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme, vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 50% (pesedhjete) te kuotave.
2. Ne rstin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendos per ceshtje shumice te cilesuar, qe parashikohen ne nenin 87 te ligjit Nr.9901 dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe



Shoqerite tregtare”, kuorumi I nevojshem eshte ai I percaktuar ne nenin 19 te ketij statute.

3. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet, per shkak te mungeses se kuorunit ne piken 1 te ketij neni, asambleja mblidhet perseri jo me vone de 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 19

KUORUMI PER VENDIMET ME SHUMICE TE CILESUAR

1. Asambleja merr vendim me $\frac{3}{4}$ (tre te katertat) kur marrin pjese ne mbledhje ortakët me te drejte vote qe zoterojne me shume se 75 (shtatedhjete e pese)% te kuotave te shoqerise, ne rastet e meposhtme:
 - a) Per ndryshimin e statutit,
 - b) Zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar,
 - c) Shperndarjen e fitimeve
 - d) Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise,

NENI 20

MARRJA E VENDIMEVE NDAJ ORTAKEVE

Vlefshmeria e vendimeve, qe percaktojne detyrime shtese mbi ortakët, apo vendimet qe kufizojne te drejtat e tyre, te parashikuara ne ligj ose ne statut, nuk kushtezohet nga miratimi I ortakut perkates.

NENI 21

E DREJTA E VOTES

1. Cdo ortak ka te drejta vote ne perpjestim me vleren nominale te kuotes se tij. Bashkezotruesit e nje kuote ushtrojne te drejtat e votes bashkerisht, sipas nenit 72 te ligjit.
2. Ortakët, qe nuk mund te jene te pranishem fizikisht ne vendin ku zhvillohet mbledhja e asamblese se pergjithshme kane te drejte qe te perfaqesohen, ose te marrin pjese nepermjet, mjeteve te ndryshme komunikimi, perfshire mjetet elektronike, me kusht qe te garantohet plotesisht identifikimi I ortakeve.
3. Mjetet elektronike perfshijne, por pa u kufizuar ne to:




- a) Transmetimin e mbledhjes se asamblese se pergjithshme ne kohe reale;
 - b) Komunikim e ndersjellte ne kohe reale, I cili u mundeson ortakev te shprehen per mbledhjen e asamblese se pergjithshme nga nje vendodhje tjeter;
 - c) Mekanizma, qe mundesojne procesin e votimit, perpara apo gjate mbajtjes se mbledhjes se asamblese se pergjithshme, pa qene nevoja te percaktohet nje perfaqesues I autorizuar, per te marre pjese fizikisht ne mbledhje;
4. Perdorimi I mjeteve elektronike, per tu mundesuar ortakeve te marrin pjese ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme, behet me kushtin qe te merren masat teknike te nevojshme per te garantuar identifikimin e ortakeve dhe sigurine e komunikimeve elektronike, deri ne ate mase qe ky perdorim te jete proporcional me arritjen e ketyre qellimeve. Nese gjate zhvillimit te mbledhjes ndodh qe te nderpfitete komunikimi mes ortakut/ve me mbledhjen per arsye teknike apo te forcave madhore, dhe ortaku apo ortaket nuk kane perfaqesuesit e tyre fizikisht ne vendin ku zhvillohet mbledhja, atehere vendimarrja do te konsiderohet e rregullt per aq kohe sa ishte vendosur lidhja drejteperdrejte me ortakun dhe/ose ortaket, gje e cila duhet shenuar ne procesverbalin e mbledhjes. Asambleja me nje shumice mbi 50% te kuotave mund te vendos perpara zhvillimit te mbledhjes , qe ne mbledhje te caktuara te asambles te jete present dhe nje noter public.
5. Ortaket kane te drejten, nga ligji apo ky statut, per te marre unanimisht cdo vendim, me kusht qe kjo marreveshje te behet me shkrim.

NENI 22

PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:
 - a) Vlersimin e veprimtarise se tij;
 - b) Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
 - c) Ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
 - d) Dhenien ose jot e perfitimeve te reja




2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues I autorizuar, I autorizuari vlersohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 23

PROCESVERBALET E MBLEDHJES SE ASAMBLESE

1. Te gjitha vendimet e asamblese se pergjithshme duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administrator pergjigjet per ruajtjen e kopjeve te procesverbaleve te mbledhjeve te asamblese se pergjithshme.
2. Procesverbali duhet te permbaje daten e vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrin e kryetarit e te mbajtesit te procesverbalit, rezultatet e votimit.
3. Procesverbalit i bashkelidhet lista e pjesmarresve dhe njoftimi I thirrjes se asamblese se pergjithshme.
4. Procesverbali I mbledhjes nenshkruhet nga kryetari, nga mbajtesi I procesverbalit (sekretari) dhe te gjitha ortaket e pranishem ne mbledhje ose perfaqesuesit e tyre. Drejtuesi I mbledhjes ka detyrimin qe te lejoje ortaket qe te kene te gjitha kohen e nevojshme qe te shqyrtojne procesverbalin e mbledhjes. Drejtuesi I mbledhjes ka detyrimin qe te perpiloje aq kopje origjinale sa ortake jane te pranishme ne mbledhje.
5. Pas nenshkrimet te procesverbalit, duhet te pergatitet vendimi I mbledhjes, I cili duhet te permbaje midis te tjerash, numrin e radhes, daten e mbledhjes ku eshte marre vendimi, bazen ligjore dhe statuore, pjesemarrjen dhe kuorumin, vendin e mbledhjes, shprehjen e qarte te asaj qe ortaket kane rene dakort ose jo, pozicionimin e tyre sipas cdo pike te rendit te dites mbi te cilin eshte marre nje vendim, nenshkrimin e ortakeve pjesmarres, ne rstin kur jane persona fizike dhe vulen e shoqerise kur jane persona juridike. Vendimi mund te zbardhet (hartohet, lexohet dhe nenshkruhet dhe/ose vulozet nga te gjitha ortaket e pranishem), ditën e mbledhjes ose ne ditet ne vijim, por ne asnje rast me vone se 10 (dhjete) dite pas pefundimit te mbledhjes. Vendimi I asamblese se ortakeve eshte I detyrueshem te behet dhe nenshkruhet (emer, mbiemer, nenshkrim, dhe vule nese ortaku eshte person juridik) ne fund te tij, ne aq kopje origjinale sa jane ortaket pjesemarrës, dhe te pakten dy kopje origjinale te tjera. Vendimi si rregull nenshkruhet nga cdo ortak, ne secilen faqe, nese ka me shume se nje faqe. Njera prej tyre duhet te mbahet nga administrator, per tu rregjistruar dhe depozituar ne arkiven e shoqerise. Kopja/et e tjera mund te perdoren per rregjistrim, nese vendimi I asamblese se pergjithshme eshte parashikuar nga statute dhe/ose nga ligji si rast I detyrueshem rregjistrimi, prane QKB apo institucioneve publike dhe/ose jopublike qe e kerkojne nje gje te tille.
6. Nje kopje e vendimeve mund tu dergohet me poste dhe ne forme elektronike ortakeve te cilet nuk kane qene pjesmarres ne mbledhje, per tu vene ne dijeni me vendimet e asamblese se pergjithshme.
7. Nese shoqeria ka publikuar nje faqe ne internet, administrator, jo me pak se 15 dite nga data e mbledhjes, eshte I detyruar te publikoje kopje te procesverbalit te mbledhjes se



asamblese se pergjithshme ne kete faqe kur ka marre fillimisht qe ne mbledhjen perkatese te asamblese miratimin per publikim per cdo mbledhje ne vecanti.

NENI 24
HETIMET E POSACME

1. Asambleja e pergjithshme mund te vendos nisjen e nje hetimi te posacem per parregullsite pergjate veprimeve te themelimit te shoqerise apo te ushtrimit te veprimtarise tregtare. Hetimi kryhet nga nje ekspert I pavarur I fushes, I cili miratohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme sipas parashikimeve te ketij statute.
2. Ortaket qe perfaqesojne te pakten 5 per qind te totalit te votave ne asamblene e shoqerise, apo nje vlere me te vogel te parashikuar ne statut dhe/ose cilido kreditor I shoqerise mund ti kerkojne asamblese se pergjithshme emeriniin e ekspertit te pavarur te fushes, kur ka dyshime te bazuara per shkelje te ligjit apo te statutit.
3. Ortaket apo kreditorët e shoqerise se percaktuar me siper, brenda 30 diteve pas refuzimit nga asambleja per emerimin e ekspertit te pavarur, mund ti kerkojne gjykates emerimin e ketij eksperti. Nese asambleja e pergjithshme nuk merr nje vendim brenda 60 diteve nga data e paraqitjes se kerkeses, kerkesa e ortakeve vlersohet e refuzuar.
4. Kur asambleja e pergjithshme ka emeruar nje ekspert te fushes per kryerjen e hetimit te posacem dhe kur per kete emerim ka dyshime te bazuara per te besuar se eksperti mund te mos realizoje hetimin e posacem ne menyren e duhur, ortaket ose kreditorët e permendur ne piken 2 te ketij neni mund ti kerkojne gjykates zevendesimin e tij.
5. Kur gjykata pranon kerkesat e permendura ne piken 2 e 3 te ketij neni, shoqeria tregtare perballon kostot e emerimit dhe te shperblimit te ekspertit te emeruar per kryerjen e hetimit te posacem.
6. E drejta per te kerkuar hetim te posacem, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, duhet te ushtrohet brenda 3 vjeteve nga data e regjistrimit te shoqerise tregtare, kur hetimi ka si objekt parregullsite e procesit te themelimit, si dhe brenda 3 vjeteve nga data e veprimit, qe konsiderohet I parregullt, kur hetimi ka si objekt parregullsite e ushtrimit te veprimtarise tregtare.
7. Kreditori, qe ne keqbesim paraqet nje kerkesë, sipas pikes 2 te ketij neni, pergjigjet ne perputhje me nenin 34 te Kodit te Procedures Civile.

NENI 25
SHFUQIZIMI I VENDIMEVE TE PARREGULLTA DHE DEMSHPERBLIMI

1. Asambleja e pergjithshme, ne baze ten je vendimi te marre me shumicen e percaktuar sipas pikes 2, neni 87, te ligjit, k ate drejte te ngreje padi perpara gjykates kompetente per shfuqizimin e vendimeve te administratoreve , si pasoje e shkeljes se rende te ligjit ose te



statutit dhe/ose padi te tjera qe parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratoreve apo ortakeve.

2. Ortaket, te cilet perfaqesojne te pakten 5 per qind te totalit te votave ne asamblene e shoqerise ose nje vlere me te vogel, te parashikuar ne statut, dhe/ose kreditoret e shoqerise, te cilet pretendojne se shoqeria ka ndaj tyre detyrime ne nje vlere jo me te vogel se 5 per qind te kapitalit, mund ti kerkojne asamblese se pergjithshme ngritjen e padise per shfuqizimin e vendimeve te administratoreve. Ortaket apo kreditoret e shoqerise te percaktuar me siper, brenda 30 diteve pas refuzimit nga asambleja per ngritjen e padise, kane te drejte te ngrejne drejteperdrejte, perpara gjykates kompetente, padi ne emer te shoqerise, per shfuqizimin e vendimit te administratoreve. Nese asambleja e pergjithshme nuk merr nje vendim, brenda 60 diteve nga data e kerkeses, kerkesa e ortakeve apo kreditoreve te percaktuar me siper vlersohet e refuzuar.
3. Asambleja e pergjithshme k ate drejte ti kerkoje gjykates perkatese shfuqizimin e vendimeve te administratoreve, kur keto perbejne shkelje te rende te ligjit ose te statutit.
4. Ortaket, te cilet perfaqesojne te cilet perfaqesojne te pakten 5 per qind te totalit te votave ne asamblene e shoqerise, mund ti kerkojne asamblese se pergjithshme ngritjen e padise si me siper. Ortaket apo kreditoret e shoqerise se percaktuar me siper, brenda 30 diteve pas refuzimit nga asambleja per ngritjen e padise, kane te drejte te ngrene padi drejteperdrejt perpara gjykates kompetente per shfuqizimin e vendimit te administratoreve. Nese asambleja e pergjithshme nuk merr nje vendim, brenda 60 diteve nga data e kerkeses, kerkesa e ortakeve apo kreditoreve vlersohet e refuzuar.
5. Ne rastet kur shoqeria ngre padi si me siper, ajo merr pjese ne gjykim me ane te nje perfaqesuesi te posacem, te caktuar nga asambleja e pergjithshme.
6. Ortaket ose kreditoret e permendur ne piken 2 te ketij neni mund ti kerkojne gjykates zevendesimin e perfaqesuesit te posacem, kur ka dyshime te bazuara se perfaqesuesi I emeruar nga asambleja e pergjithshme mund te mos ngreje e ndjek padine ne interesin me te mire te shoqerise. Nese gjykata e pranon kete kerkesa, kostot e emerimit dhe te shperblimit te perfaqesuesit perballohen nga shoqeria.
7. Gjykata vendos shpalljen e pavlefshmerise se vendimit te administratoreve, nese keta nuk merren vesh, me pajtim, me perfaqesuesin e posacem per korrigjimin e pasojave te vendimit, brenda 30 diteve nga data e emerimit te ketij perfaqesuesi. Te drejtat e paleve te treat mbeten te pacenuara, ne perputhje me piken 3 te nenit 12 te ketij ligji.
8. Ortaket ne pakice dhe kreditoret e percaktuar me siper kane te drejtat e parashikuara ne pikat 2 e 4 te ketij neni, edhe ne rastin kur asambleja e pergjithshme nuk merr vendim, ose refuzon te vendos per kerkesen e tyre per ngritjen ndaj administratoreve te padise, me objekt shperblimin e demit te pesuar nga shoqeria, si vendim I paligjshem, apo per ngritjen e padive te tjera qe parashikon ky ligj ose statute ndaj administratoreve apo ortakeve.
9. Dispozita e paragrafit te gjashte te nenit 91 te ligjit Nr.9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" zbatohet edhe per keto padi.

NENI 26
TE DREJTAT E LIDHURA ME KUOTEN

Ortaku, qe pengohet te ushtroje te drejtat qe I rrjedhin nga zoterimi I kuotes se shoqerise, k ate drejte ti kerkoje gjykates te urdheroje ndalimin e cenimit apo shperblimin e demit te shkaktuar, si pasoje e cenimit te ketyre te drejtave.

NENI 27
NDALIMI I KUFIZIMEVE

1. Jane te pavlefshme dispozitat e statutit, qe kufizojne ose perjashtojne ndonje nga te drejtat e ortakeve ose te kreditoreve, sipas percaktimeve te bera ne nenet 91, 92 e 93 te ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", si dhe dispozitat, qe parashikojne kufizime te pergjithshme te veprimeve te percaktuara ne keto nene.
2. Vendimet e asamblese se pergjithshme nuk mund te cenojne te drejten e ortakeve ose te kreditoreve per te kryer veprimet e parashikuara ne nenet 91, 92 e 93 te ligjit Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

ADMINISTRATORI

NENI 28
EMERIMI, SHKARKIMI, TE DREJTAT DHE DETYRIMET

1. Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administrator te shoqerise. Afati I emerimit, I cili caktohet ne statut, nuk mund te jete me I gjate se 3 (tre) vjet, me te drejte ripertesitje. Asambleja e Pergjithshme merr vendim te posacem per riemerimin e Administratorit pas periudhes se emerimit te pare. Emerimi I administratoreve, I cili hyne ne fuqi ne daten e percaktuar sipas aktit te emerimit, u kundrejtohet paleve te treta sipas percaktimeve te nenit 12 te ligjit tregtar.
2. Caktimi I Administratorit behet nga ky statut per nje periudhe 3 (tre) vjecare me te drejte riemerimi nga Asambleja e Ortakeve. Asambleja zgjedh administratorin e saj me shumice te thjeshte votash. Administrator I pare I shoqerise caktohet Ornel Ajdinaj shtetas shqiptar, madhor me zotesi juridike per te vepruar, I biri i Petrir, lindur me date 01.10.1976 ne Berat, me Karte ID Nr.H61001053K dhe banues ne Berat.
3. Administrator mund te heqe dore ne cdo kohe nga detyra e tij, nepermjet nje njoftimi me shkrim drejtuar asamblese se pergjithshme. Administratori, qe jep doreheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarise se shoqerise, eshte gjithashtu I detyruar te therrase




asamblene e pergjithshme per emerimin e administratorit te ri, perpara dates ne te cilen doreheqja te hyje ne fuqi.

4. Nese asambleja e pergjithshme nuk vendos emerimin e administratorit te ri ne daten e percaktuar ne thirrjen e kryer nga administrator I dorehequr, atehere administrator njofton me shkrim doreheqjen Qendres Kombetare te Regjistrimit, se bashku me kopjen e thirrjes se mbledhjes se asamblese se pergjithshme dhe Qendra Kombetare e Regjistrimit regjistron largimin e administratorit, sipas procedurave te ligjit nr. 9723, date 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", te ndryshuar.
5. Doreheqja e administratorit nuk cenon padite e shoqerise per shkelje te detyrimit te besnikerise qe administrator ka ndaj saj, sipas ketij ligji."

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a) Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimatrise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b) Perfaqesoje shoqerine tregtare ne marrdhenie me te tretet;
- c) Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d) Njoftoje ortaket per mbledhjen e shoqerise me kerkese te tij ose te njerit ose disa prej ortakeve;
- e) Mbaje nje rregjister te vecante ku te bej rregjistrimin e te gjitha vendimeve te Asamblese se Pergjithshme. Te mbaje te gjithe dokumentacionin e nevojshem qe duhet per cdo mbledhje, pervec te tjerave, njoftimin per thirrjen e mbledhjes, procesverbalin dhe vendimin e asamblese te nenshkruar nga te gjithe ortaket pjesemarrres, dhe dokumentat shoqeruese qe jane diskutuar ne mbledhje;
- f) Mbaje lidhje te ngushta me ortaket dhe te respektoje etiken ne komunikim dhe marrdhenie me ta.
- g) Lidhe kontratat e punes me punonjesit e shoqerise;
- h) Mbaje korespondence te rregullt me te tretet, si dhe te marre te gjitha masat qe kjo te jete e arkivuar ne arkiven e shoqerise;
- i) Siguroje akses te lire dhe te pakushtezuar prej secilin prej ortakeve, qe te njihet me cdo dokument qe keta te fundit e vlersojne te rendesishme ne mbarevajtjen e veprimtarise se shoqerise;
- j) Raportoje me shkrim ndaj asamblese se pergjithshme per veprimatrine tremujore te shoqerise, edhe nese asambleja apo secili prej ortakeve nuk e ka kerkuar shprehimisht kete raport. Ky raport duhet te dergohet me shkrim dhe I nenshkruar nga administratori, zyrtarisht me poste dhe/ose me poste elektronike, ne adrese te ortakeve te shoqerise.
- k) Pergatise dhe nenshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise, dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, I paraqet keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;



- l) Krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- m) Kryeje regjistrimet dhe dergoje te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
- n) Raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimatrine e shoqerise tregtare;
- o) Kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne kete statut.

Ne rastet e parashikuara nga pikat 3 e 5 te nenit 82 te ligjit Nr.9901 dt 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare", administrator eshte i detyruar te therrase asamblene e pergjithshme.

NENI 29

PERFAQESIMI

- 1.Kufizimet e tagrave te perfaqesimit te administratorit i kundrejtohen paleve te treta, ne perputhje me dispozitat e nenit 12 te ketij ligji.
- 2.Tagrat e perfaqesimit te administratorit dhe cdo ndryshim i tij njoftohet per rregjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

NENI 30

SHPERBLIMI

- 1.Shperblimi baze te administratorit mund t'i behen shitesa. Shtesat behen me vendim te posacem te asamblese se ortakeve sipas nenit 86 te Ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".
- 2.Shperblimi, sipas pikes 1 te ketij neni, duhet te jete i pershtatshem dhe ne perputhje me detyrat e administratorit, gjendjen financiare te shoqerise dhe te respektoje nivelet minimale te kerkuara nga legjislacioni ne fuqi .
- 3.Nese shoqeria eshte ne veshtiresi financiare, asambleja e pergjithshme mund te vendose reduktimin e shperblimit te administratorit ne masen e pershtatshme.
- 4.Kriteret e shperblimit, shperblimi individual dhe efekti vjetor i shperblimit te administratorit ne strukturen e kostove te shoqerise tregtare publikohen sebashku me pasqyrat financiare vjetore.

NENI 31

DETYRIMI I BESNIKERISE DHE PERGJEGJESIA



1. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas nenëve 14,15,17,18 të ligjit Nr.9901, dt 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëri tregtare”, administratori detyrohet:

a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis,

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj ose në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita,

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim,

d) të parandalojë dhe menjëherë rastet e konfliktit, prezente apo të mundshme, të interesave personale me ata të shoqërisë,

e) të garantojë mirëatimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikës 3 të nenit 13 të Ligjit nr.9901 dt 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave të mësipërme të këtij neni, është i detyruar t’i demshperblejë shoqërisë dëm, që rrjedhin nga kryerja e shkëlqes, si dhe t’i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standarteve të kerkuara.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t’i demshperblejë shoqërisë dëm të shkaktuar, nëse në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, kryen veprimet e mëposhtme :


a) i kthen ortakëve kontributet,

b) i paguan ortakëve interesat apo dividende,

c) i shpërndajnë aktivet shoqërisë,

d) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhet të parashikohet që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet,

e) jep kredi.



5. Dispozitat e pikes 6 te nenit 92 te ketij ligji zbatohen edhe per padite, qe rrjedhin nga paragrafet e ketij neni. Keto padi duhet te ngrihen brenda 3 (tre) vjeteve nga kryerja e shkeljes apo zbulimi i saj.

TITULLI V

PRISHJA E SHOQERISE, LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

KREU I

PRISHJA E SHOQERISE

NENI 32

SHKAQET E PRISHJES SE SHOQERISE

1. Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar prishet:

a) kur mbaron kohezgjatja, per te cilen eshte themeluar,

b) me perfundimin e procedurave te falimentimit apo ne rast te pamjaftueshmerise se pasurive per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit,

c) ne rast se objekti behet i parealizueshem per shkak te mosfeksionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe te tjera qe e bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregtare,

d) ne rastet se objekti behet i parealizueshem per shkak te mosfeksionimit te vazhduar te organeve te shoqerise apo per shkaqe te tjera qe e bejne absolutisht te pamundur vazhdimin e veprimtarise tregtare,

e) ne raste te tjera, te parashikuara ne statut,

f) ne raste te tjera te parashikuara ne ligj,

g) per shkak tjeter te vendosur nga asambleja e ortakeve

2. Prishja e shoqerise, si pasoje e nje apo me shume prej shkaqeve te percaktuara ne shkronjat "a", "c", "d", "dh" dhe "e", te pikes 1, te ketij neni, vendoset nga asambleja e ortakeve me shumicen e parashikuar sipas pikes 1, te nenit 87, te ketij ligji.

3. Ne rast mosveprimi te asamblese se ortakeve per te vendosur prishjen, per shkaqet e percaktuara me siper, cdo person i interesuar mund ne cdo kohe, t'i drejtohet gjykates per te konstatuar prishjen e shoqerise.

4. Pavaresisht nga parashikimet e siperpermendura, ekszistenca e nje a me shume shkaqeve, te parashikuara ne kete nen, nuk do te kete si pasoje prishjen e shoqerise dhe hapjen e procedurave



te likujdimit, nese perpara vendimit gjyqesor te formes se prere, shkaku u prishjes eshte korrigjuar, nese eshte e mundshme te korrigjohet dhe ky korrigjim eshte publikuar nga shoqeria ne rregjistrin tregtar, sipas parashikimeve te ligjit nr.9723, date 03.5.2007, "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit", te ndryshuar.

5.Prishja e shoqerise si pasoje e shkaqeve te parashikuara ne shkronjen "b", te pikes 1, e ketij neni, vendoset nga gjykata kompetente per procedurat e falimentimit, kur, ne perfundim te ketyre procedurave, te gjitha pasurite e shoqerise jane likujduar per shlyerjen ne menyre kolektive te detyrimeve ndaj kreditoreve apo kur gjykata kompetente per procedurat e falimentimit vendos rrezimin e kerkeses per hapjen e procedures se falimentimit per shkak te pamjaftueshmerise se pasurise se shoqerise per te mbuluar shpenzimet e procedures se falimentimit.

6.Prishja e shoqerise si pasoje e shkaqeve te parashikuara ne shkronjen "c", te ketij neni, vendoset nga gjykata kompetente, sipas parashikimeve te nenit 3/1 te ligjit tregtar.

Neni 33

REGJISTRIMI I SHPERBERJES

1.Administratori ka detyre te rregjistroje shperberjen e shoqerise prane Qendres Kombetare te Rregjistrimit, ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit". Nese prishja e shoqerise behet me vendim gjykate, gjykata ne perputhje me nenin 45 te ligjit nr.9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit" ia njofton vendimin Qendres Kombetare te Rregjistrimit per rregjistrim.

2.Ne rastin e shperberjes se shoqerise, pavaresisht insituacionit qe ka marre vendimin e asamblese dhe/ose gjykates, ngarkohet administratori qe te kryeje procedurat deri ne perfundim te ketij procesi, per aq kohe sa, kjo dispozite e statutit nuk vjen ne kundersiztim me legjislacionin ne fuqi.

KREU II

LARGIMI DHE PERJASHTIMI I ORTAKEVE

NENI 34

LARGIMI I ORTAKUT PER SHKAQE TE ARSYESHME

1.Ortaku mund te largohet nga shoqeria nese ortaket e tjere ose shoqeria kane kryer veprime ne dem te tij, nese eshte penguar te ushtroje te drejtat e tij, nese shoqeria i ka ngarkuar detyrime te paarsyeshme apo per shkaqe te tjera, qe e bejne te pamundur vazhdimin e ortakerise.



2.Ortaku qe kerkon largimin, duhet te njoftoje shoqerine me shkrim, si dhe te parashtroje shkaqet e largimit.

3.Administratori duhet te therrase mbledhjen e asamblese se pergjithshme menjehere pasi te kete marre dijeni per njoftimin e largimit, sipas pikes 2 te ketij neni, per te vendosur nese ortakut do t'i anulohet dhe/ose likujdohet kuota, si pasoje e largimit per shkaqe te arsyeshme.

4.Ortaku ka te drejte te ngreje padi ne gjykate ndaj shoqerise per likujdimin e kuotes, si pasoje e largimit per shkaqe te arsyeshme, nese pas njoftimit te largimit asambleja e pergjithshme nuk mblidhet apo nuk njeh si te arsyeshme shkaqet e largimit dhe likujdimit te kuotes.

5.Ortaku qe largohet ka te drejte te ngreje padi ndaj shoqerise dhe/ose ortakeve te tjere qe shkaktuan largimin e tij dhe te kerkoje ndaj tyre, ne menyre solidare, shperblimin e demit te pesuar.

NENI 35

PERJASHTIMI I ORTAKUT

1.Asambleja e pergjithshme mund t'i kerkoje gjykates perjashtimin e ortakut, nese ai nuk ka shlyer kontributin e tij, sipas parashikimeve te statutit ose nese ekzistojne shkaqe te tjera te arsyeshme per kete perjashtim.

2.Konsiderohen shkaqe te arsyeshme per perjashtimin e ortakut, sipas pikes 1 te ketij neni, por pa u kufizuar ne to, rastet kur ortakut:

- a)me dashje apo me pakujdesi te rende i shkakton deme shoqerise ose ortakeve te tjere
- b)me dashje apo me pakujdesi te rende shkel statutin ose detyrimet e percaktuara me ligj,
- c)perfshihet ne veprime, te cilat e bejne te pamundur vazhdimin e marredhenieve midis shoqerise tregtare dhe ortakut, ose
- d)me veprimet e tij demton ose pengon ndjeshem veprimtarine tregtare te shoqerise,
- e)mungon per me shume se dy mbledhje rresht ne asamblene e epergjithshme, duke mosmarre pjese personalisht e as me perfaqesues, ne menyre te pajustificuar dhe pa njoftim paraprak, megjithese ka pasur njoftim te rregullte sipas parashikimeve te ketij statuti.

3.Gjate procedures se perjashtimit te ortakut, me kerkese te paditesit, gjykata mund te marre nje mase per sigurimin e padise, duke pezulluar te drejten e votes se ortakut, qe kerkohet te perjashtohet, si dhe te drejtat e tjera, qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes se shoqerise, kur ajo e vlereson kete mase si te nevojshme dhe te pajustificuar.



4. Shoqeria ka te drejte t'i kerkoje ortakut te perjashtuar shperblimin e demit te pesuar nga veprimet, qe kane sjelle perjashtimin.

5. Ortaku ka te drejte t'i kerkoje shoqerise shperblimin e demit te pesuar, nese kerkesa per perjashtim nuk eshte e bazuar.

6. Ortaku nuk ka te drejte t'i kerkoje shoqerise likujdimin e kuotes, nese ai perjashtohet per shkaqe te arsyeshme, por, nese shoqeria ngre ndaj tij padi per shperblim demi, ortakut ka te drejte te kompesoje cdo shume, qe do te kishte te drejte ta perfitonte ne cilesine e likujdimit te kuotes, me demin e kerkuar nga shoqeria.

NENI 36

PASOJAT E LARGIMIT DHE PERJASHTIMIT

1. Te gjitha te drejtat qe rrjedhin cilesia e ortakut ne shoqeri, shuhen ne dtaen e largimit ose te vendimit te formes se prere te gjykates per largimin ose perjshtimin.

2. Statuti nuk mund te perjashtoje apo te kufizojte te drejten e ortakut per t'u larguar nga shoqeria dhe te drejten e shoqerise per te perjashtuar ortakun.

NENI 37

LIKUIDIMI NE GJENDJEN E AFTESISE PAGUESE

Me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi, prishja e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar ka si pasoje hapjen e procedurave te likujdimit ne gjndjen e aftesise pagues, sipas neneve 190 deri ne 205 te ketij ligji.


NENI 38

DISPOZITA TRANZITORE DHE TE FUNDIT

1. Per cdo gje qe nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete statut qe lidhet me funksionimin e shoqerise, zbatohet legjislacioni shqiptare ne fuqi ne momentin e nenshkrimit te ketij statuti.

2. Ne cdo rast kur legjislacioni shqiptar perkates mund te ndryshoje, ky statut me vendim te asamblese se ortakeve, sipas rregullave te percaktuara mund te ndryshohet, ne perputhje me ndryshimet perkatese te legjislacionit ne fuqi.


3. Statuti i meparshem i shoqerise shfuqizohet.



4.Ky statut hartohet ne tre kopje origjinale dhe hyn ne fuqi per palet nenshkruese nga data e nenshkrimt te tij dhe prodhon efekte ndaj te treteve nga data e regjistrimit te tij ne QKB.

ORTAKET THEMELUES

Ornel AJDINAJ



Emer, Mbiemer, Firma